



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2025:171191

Datë: 14.11.2025

Numri i dokumentit: 08066754

KE.nr.806/25

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit/ propozuesit të masës së sigurimit “Birra Peja” SH.A., me NUI: 811277939, me seli në Pejë, rruga “Nexhdet Basha”, nr.160, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Vegim Kraja dhe Kujtesa Nezaj – Shehu, avokatë në Prishtinë, kundër të paditurve/kundërshtarëve të masës së sigurimit “United Capital Ventures” me NIPT: L12212001V, me seli në Shipëri dhe “United Capital Ventures” SH.P.K., me NUI: 812011039, me seli në Prishtinë, Magjistratja Prishtinë – Ferizaj, km 4, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Veli Hoti, avokat në Prishtinë, me objekt kontesti vërtetim i shkëljes së markës tregtare me propozim për caktimin e masës së sigurisë, jashtë seancës, me datë 14.11.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET se është tërhequr padia dhe propozimi për caktimin e masës së sigurimit i propozuesit të sigurimit “Birra Peja” SH.A., me numër KE.nr.806/25 të datës 29.08.2025, kundër të paditurit/ kundërshtarit të parë të sigurimit “United Capital Ventures” me NIPT: L12212001V, me seli në Shqipëri.
- II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi/propozuesi i masës së sigurimit “Birra Peja” SH.A., përmes të autorizuarit të tij, me datë 29.08.2025, ka paraqitur pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, padi për vërtetimin e

shkeljes së markës tregtare dhe të drejtës së autorit me propozim për caktimin e masës së sigurisë, kundër të paditurve/kundërshtarëve të sigurimit “United Capital Ventures” dhe “United Capital Ventures” SH.P.K. Me propozimin për caktimin e masës së sigurisë, ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit ashtu që të i ndalohet kundërshtarit të sigurimit çdo aktivitet i cili shkel markën tregtare të regjistruar të paditësit me numër 019660 dhe/ose të drejtën e autorit mbi dizajnin e produktit “Birra Peja”, përfshirë prodhimin, importimin, eksportimin, vendosjen në treg, shitjen, magazinimin dhe çfarëdo mënyre tjetër të produkteve shkelëse “Birra VATAN”; dhe të urdhërohet konfiskimi dhe largimi nga tregu i të gjitha produkteve “Birra VATAN”, të cilat shkelin të drejtën e markës tregtare figurative të propozuesit të masës së sigurimit me numër 019660 dhe/ ose të drejtën e autorit mbi dizajnin e produktit “Birra Peja”.

I autorizuari i paditësit/ propozuesit të masës së sigurimit me datë 30.09.2025 ka dorëzuar në gjykatë parashtresën për korrigjimin dhe precizimin e padisë dhe propozimit për caktimin e masës së sigurimit në aspektin subjektiv, dhe ka njoftuar gjykatën se tërhiqet nga padia dhe propozimi për masë sigurie ndaj të paditurit/ kundërshtarit të sigurimit “United Capital Ventures” me NIPT: L12212001V, me seli në Shqipëri, pasi që çështja në raport me të paditurin është trajtuar nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm në Tiranë. Andaj gjykatës i ka propozuar që të konstatoj të tërhequr padinë dhe propozimin për caktimin e masës së sigurisë ndaj “United Capital Ventures” me NIPT: L12212001V, me seli në Shqipëri,

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtresës së përfaqësuesit të paditësit, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c) dhe nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.805/25, datë 14.11.2025

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.